<p>Mungesa e institucioneve publike në shërbim të të rinjve në Bashkinë e Shkodrës solli si domosdoshmëri fillimin e punës për përgatitjen e një projekti me shërbimet e nevojshme për objektin e hapësirën e duhur.</p> <p>Mungesa e disa shërbimeve socio-edukative për të rinjtë nga institucionet publike solli si domosdoshmëri fillimin e punës për përgatitjen dhe implementimin e një projekti me shërbime specifike.</p> <p>Kjo situatë solli që Bashkia e Shkodrës të vendoste në objektivat e saja ndërtimin dhe vënien në funksion të një qendre rinore publike, dedikuar promovimit të përfshirjes artistike, kulturore dhe sociale të të rinjve. Të rinjtë janë një forcë pozitive për ndryshim, ndaj dhe zhvillimi i strategjive dhe investimeve do të synojë zhvillimin e tyre. Për më tepër, zhvillimi rinor është një nga prioritetet e Bashkisë së Shkodrës, kështu që krijimi i një strukture publike në mbështetje të rinisë është pika kyçe në krijimin e një sistemi mbështetës për ta.</p> <p>Kjo situatë bëri të mundur që Bashkia Shkodër të vendoste në objektivat e saj ndërtimin dhe vënien në funksion të një qendre rinore publike, e cila ka për si objektivi të përgjithshëm promovimin gjithpërfshirës social dhe zhvillimin shumë-dimensional të të rinjve, mbështetjen e pjesëmarrjes aktive në zhvillimin social dhe kulturor të Bashkisë Shkodër.</p> <p>Duke marrë parasysh që zhvillimi i rinisë është një nga prioritetet e Bashkisë Shkodër, kjo qendër hyn në shërbim si një hapësirë shumë-funksionale e takimit rinor dhe synon aksesin në shërbime si: edukimin formal dhe joformal, sipërmarrje, kulturë, informacion dhe ICT training, pavarësisht nga gjinia, raca, etnia, kultura, besimi, paafërsia dhe orientimi seksual gjithashtu synon promovimin dhe organizimin e iniciativave të propozuara "nga" dhe "për" të rinjtë, për të favorizuar shkëmbimin e përvojave, me qëllim parandalimi të situatave të izolimit social të të rinjve.</p> <p>Me krijimin dhe vënien në funksion të qendrës rinore "Atelie" qendra shërben si një hapësirë gjithëpërfshirëse për rininë e Bashkisë Shkodër duke zhvilluar një sërë aktivitetesh shumë dimensionale për të rinjtë dhe nga të rinjtë.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja dhe fuqizimi i të rinjve, duke stimuluar kapacitetin dhe shprehitë e tyre krijuese, inovative dhe sipërmarrëse për projektimin e të ardhmes së tyre dhe zhvillimin e komunitetit. • Përmirësimi i aksesit në informacion për të rinjtë për punësimin, kulturën, edukimin formal dhe joformal, duke konsideruar në mënyrë të veçantë të rinjtë me aftësi të kufizuara. • Inkurajimi i interesimit rinor drejt edukimit formal dhe jo formal me anë të bashkëpunimit me institucionet arsimore dhe orientimit në karrierë. • Inkurajimi i dialogut rinor, përmirësimi i njohurive në qytetarinë aktive, rritja e kapaciteteve të organizatave rinore dhe forcimi i vullnetarizmit. • Funksionimi, konsolidimi i shërbimeve si: informim, edukim dhe trajnime profesionale pranë qendrës rinore publike. • Ndërgjegjësim për parandalimin e përdorimit të drogave. • Zhvillimin e një kulture të përkujdesit ndaj problematikave rinore. • Bashkëpunim me institucionet publike, aktorët lokal dhe kombëtar që kanë synim zhvillimin e rinisë. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Programimi dhe organizimi i aktiviteteve rinore në Qendrën Rinore. • Mirëmbajtja e web/facebook të Qendrës Rinore www.shkodrarinore.gov.al. • Mbështetjen OJF-ve, kontribues në zhvillimin e rinisë dhe organizimi i takimeve periodike. • Stimulimi i dialogut mes të rinjve dhe autoriteteve publike, inkurajimi i qytetarisë aktive, rritje e kapaciteteve të OjF-ve rinore dhe inkurajim i vullnetarizmit. • Mirëmbajtja dhe zhvillimi i aspekteve komunikuese (broshura, fletëpalosje, gazetë periodike). • Organizim i trajnimeve mbi qytetarinë aktive dhe edukimin politik. • Organizimin i trajnimeve mbi punësimin dhe sipërmarrjen. • Organizimi i laboratoreve të edukimit jo formal me të rinjtë e shkollave të Bashkisë Shkodër me OJF lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. • Organizimin e iniciativave vullnetare. • Organizimi i dy shfaqje teatrale me të rinjtë të talentuar të bashkisë Shkodër. • Organizimin i së paku dy koncerteve pranë Qendrës rinore Atelie me të rinjtë të talentuar në muzikë. • Ngritja e Këshillit Rinor Lokal dhe realizimi i takimeve periodike. • Organizimi i aktiviteteve mësimore pas-shkollore. • Organizimi i takimeve për ndërgjegjësim në lidhje me shëndetin, çështjet sociale dhe parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike. • Organizimin e ekspozitave të të rinjve të Bashkisë Shkodër pranë Qendrës Rinore Atelie. 		
b) Rezultatet që prisni		

- Rritje mundësish për përfshirje sociale dhe fuqizim të të rinjve.
- Stimulim i krijimtarisë artistike, ideve inovative dhe aftësive sipërmarrëse tek të rinjtë.
- Përmirësim dhe lehtësim të aksesit në informacion të të rinjve, me kujdes të veçantë për të rinjtë me aftësi ndryshe.
- Stimulimi i dialogut mes të rinjve dhe autoriteteve publike dhe inkurajimi i qytetarisë aktive.
- Rritje kapaciteteve të OJF-ve Rinore.
- Inkurajimi i vullnetarizmit tek të rinjtë.
- Promovimi i talentëve.

c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt				
Të rinjtë e Bashkisë Shkodër Komuniteti OJF Universiteti i Shkodrës		IADSA , Bashkia Shkodër Ministria e fëmijëve dhe Rinisë Organizatrat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare partnerë të Bashkisë Shkodër				
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Energji elektrike	350			350	
A.2	Ujë	25			25	
A.3	Mirëmbajtje e zakonshme	300			300	
A.4	Servis teknik Ashensori	200			200	
A.5	Materiale elektrike dhe hidraulike	20			20	
A.6	Blerje materiale pastrimi	100			100	
A.7	Sigurimi i pronave	30			30	
	Shuma	1,025			1,025	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Gjatë vitit 2024		Qendra Rinore Atelie, Drejtoria e Përgjithshme e Mir. Objekteve Publike dhe Sher. Mbeshtetese. Institucioni Ikujudues: Drejtoria e Përgjithshme e Mir. Objekteve Publike dhe Sher. Mbeshtetese.				

Nr.27	P10430.Q4.O1.A5 Shpenzime per sigurimin e funksionimit e plote te Qendrës Rinore	Funksioni 10: Mbrojtja Sociale N/funksioni 10: Familja dhe Fëmijët Lloji i programit 10430: Kujdesi Social për Familjen dhe Fëmijët
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Mungesa e institucioneve publike në shërbim të të rinjve në Bashkinë e Shkodrës solli si domosdoshmëri fillimin e punës për përgatitjen e një projekti me shërbimet e nevojshme për objektin e hapësirën e duhur.</p> <p>Mungesa e disa shërbimeve socio-edukative për të rinjtë nga institucionet publike solli si domosdoshmëri fillimin e punës për përgatitjen dhe implementimin e një projekti me shërbime specifike.</p> <p>Kjo situatë solli që Bashkia e Shkodrës të vendoste në objektivat e saja ndërtimin dhe vënien në funksion të një qendre rinore publike, dedikuar promovimit të përfshirjes artistike, kulturore dhe sociale të të rinjve. Të rinjtë janë një forcë pozitive për ndryshim, ndaj dhe zhvillimi i strategjive dhe investimeve do të synojë zhvillimin e tyre. Për më tepër, zhvillimi rinor është një nga prioritetet e Bashkisë së Shkodrës, kështu që krijimi i një strukture publike në mbështetje të rinisë është pika kyçe në krijimin e një sistemi mbështetës për ta.</p> <p>Kjo situatë bëri të mundur që Bashkia Shkodër të vendoste në objektivat e saj ndërtimin dhe vënien në funksion të një qendre rinore publike, e cila ka për si objektiv të përgjithshëm promovimin gjithëpërfshirës social dhe zhvillimin shumë-dimENSIONAL të të rinjve, mbështetjen e pjesëmarrjes aktive në zhvillimin social dhe kulturor të Bashkisë Shkodër.</p> <p>Duke marrë parasysh që zhvillimi i rinisë është një nga prioritetet e Bashkisë Shkodër, kjo qendër hyn në shërbim si një hapësirë shumë-funksionale e takimit rinor dhe synon aksesin në shërbime si: edukimin formal dhe joformal, sipërmarrje, kulturë, informacion dhe ICT training, pavarësisht nga gjinia, raca, etnia, kultura, besimi, paaftësia dhe orientimi seksual gjithashtu synon promovimin dhe organizimin e iniciativave të propozuara "nga" dhe "për" të rinjtë, për të favorizuar shkëmbimin e përvojave, me qëllim parandalimi të situatave të izolimit social të të rinjve.</p> <p>Me krijimin dhe vënien në funksion të qendrës rinore "Atelie" qendra shërben si një hapësirë gjithëpërfshirëse për rininë e Bashkisë Shkodër duke zhvilluar një sërë aktivitetesh shumë dimensionale për të rinjtë dhe nga të rinjtë.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja dhe fuqizimi i të rinjve, duke stimuluar kapacitetin dhe shprehjet e tyre krijuese, inovative dhe sipërmarrëse për projektimin e të ardhmes së tyre dhe zhvillimin e komunitetit. • Përmirësimi i aksesit në informacion për të rinjtë për punësimin, kulturën, edukimin formal dhe joformal, duke konsideruar në mënyrë të veçantë të rinjtë me aftësi të kufizuara. • Inkurajimi i interesimit rinor drejt edukimit formal dhe jo formal me anë të bashkëpunimit me institucionet arsimore dhe orientimit në karrierë. • Inkurajimi i dialogut rinor, përmirësimi i njohurive në qytetarinë aktive, rritja e kapaciteteve të organizatave rinore dhe forcimi i vullnetarizmit. • Funksionimi, konsolidimi i shërbimeve si: informim, edukim dhe trajnime profesionale pranë qendrës rinore publike. • Ndërgjegjësim për parandalimin e përdorimit të drogave. • Zhvillimin e një kulture të përkujdesit ndaj problematikave rinore. • Bashkëpunim me institucionet publike, aktorët lokal dhe kombëtar që kanë synim zhvillimin e rinisë. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Programimi dhe organizimi i aktiviteteve rinore në Qendrën Rinore. • Mirëmbajtja e web/facebook të Qendrës Rinore www.shkodrarinore.gov.al. • Mbështetjen OJF-ve, kontribues në zhvillimin e rinisë dhe organizimi i takimeve periodike. • Stimulimi i dialogut mes të rinjve dhe autoriteteve publike, inkurajimi i qytetarisë aktive, rritje e kapaciteteve të OjF-ve rinore dhe inkurajim i vullnetarizmit. • Mirëmbajtja dhe zhvillimi i aspekteve komunikuese (broshura, fletëpalosje, gazetë periodike). • Organizim i trajnimeve mbi qytetarinë aktive dhe edukimin politik. • Organizimin i trajnimeve mbi punësimin dhe sipërmarrjen. • Organizimi i laboratoreve të edukimit jo formal me të rinjtë e shkollave të Bashkisë Shkodër me OJF lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. • Organizimin e iniciativave vullnetare. • Organizimi i dy shfaqje teatrale me të rinjtë të talentuar të bashkisë Shkodër. • Organizimin i së paku dy koncerteve pranë Qendrës rinore Atelie me të rinjtë të talentuar në muzikë. • Ngritja e Këshillit Rinor Lokal dhe realizimi i takimeve periodike. • Organizimi i aktiviteteve mësimore pas-shkollore. • Organizimi i takimeve për ndërgjegjësim në lidhje me shëndetin, çështjet sociale dhe parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike. • Organizimin e ekspozitave të të rinjve të Bashkisë Shkodër pranë Qendrës Rinore Atelie. 		
b) Rezultatet që prisni		

<ul style="list-style-type: none"> • Rritje mundësish për përfshirje sociale dhe fuqizim të të rinjve. • Stimulum i krijimtarisë artistike, ideve inovative dhe aftësive sipërmarrëse tek të rinjtë. • Përmirësim dhe lehtësim të aksesit në informacion të të rinjve, me kujdes të veçantë për të rinjtë me aftësi ndryshe. • Stimulimi i dialogut mes të rinjve dhe autoriteteve publike dhe inkurajimi i qytetarisë aktive. • Rritje kapacitetesh të OJF-ve Rinore. • Inkurajimi i vullnetarizmit tek të rinjtë. • Promovimi i talenteve. 						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Të rinjtë e Bashkisë Shkodër Komuniteti Universiteti i Shkodrës OJF			IADSA Bashkia Shkodër Ministria e fëmijëve dhe Rinisë Organizatrat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare partnerë të Bashkisë Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Blerje materiale kancelarike	50			50	
A.2	Domain dhe host	12			12	
	Shuma	62			62	
ërf) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2024			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Qendra Rinore Atelie, Sektori I Rinisë Drejtoria e Sherbimeve Sociale Institucioni Ilkujdues: Bashkia Shkodër			

Nr.28	P10430.Q4.O2. A16 "Realizimi i Aktiviteve për Rininë"	Funksioni 10: Mbrojtja Sociale N/funksioni 10: Familja dhe Fëmijët Lloji i programit 10430: Kujdesi Social për Familjen dhe Fëmijët
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
<p>Rinia e Bashkisë Shkodër është një forcë aktive në komunitet, e cila përfshin individë të apasionuar dhe të përkushtuar për të kontribuar në zhvillimin e qytetit dhe të kulturës së tij. Ndërkaq, nevoja për të përfshirë rininë është e rëndësishme për të siguruar një përqendrim më të mirë të potencialeve të tyre në dobi të zhvillimit të qytetit dhe të komunitetit të tij në përgjithësi.</p> <p>Këta të rinj aktivë të Bashkisë Shkodër, megjithatë, përballen me sfidat e mungesës së një buxheti të dedikuar për ta. Pa një burim financiar, ata shpesh ndeshen me vështirësi për të realizuar projektet e tyre, për të mbështetur aktivitetet e tyre dhe për të shfaqur talentet e tyre në mënyra të ndryshme. Mungesa e një buxheti specifik për rininë shpesh kufizon mundësitë e tyre për të financuar aktivitete të ndryshme kulturore, artistike, sportive dhe shoqërore. Kjo i bën ata të varur prej ndihmës financiare të jashtme, duke e bërë më të vështirë për ta të zhvillojnë potencialin e tyre dhe për të kontribuar në komunitetin e tyre në mënyra të kreativitetit dhe inovacionit.</p> <p>Dita Ndërkombëtare e Rinisë: Kjo është një mundësi e shkëlqyer për të festuar dhe të nderuar rininë në një atmosferë argëtuese dhe frymëzuese. Aktivitetet argëtuese, si lojërat sportive, konkurse artistike, dhe punëtori kreative, do të inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të rinisë. Ndërsa një koncert i organizuar me artistë të rinj do të jetë një platformë e shkëlqyeshme për të shfaqur talentet muzikore dhe artistike të tyre.</p> <p>Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit: Një ditë e dedikuar vullnetarizmit do të inkurajojë rininë të angazhohen në aktivitete të dobishme për komunitetin e tyre. Përfshirja në fushata të pastrimit të mjedisit, ndihmën për të moshuarit, ose organizimin e aktiviteteve bamirëse do të ndihmojë në kultivimin e ndjenjës së përgjegjësisë sociale dhe solidaritetit në mesin e rinisë.</p> <p>Organizimi i Javës së Demokracisë Rinore është një mundësi e shkëlqyer për të trajnuar, shkëmbyer ide dhe përvoja, si dhe për të përparuar politikën rinore dhe për të promovuar angazhimin e rinisë.</p> <p>Eskursione Rinore: Eskursionet rinore janë një mënyrë e shkëlqyer për të rinjtë për të eksploruar natyrën, për të ndërtuar lidhje të reja, dhe për të pasur përvoja të reja. Organizimi i udhëtimeve në zonat e bukura natyrore ose në qytete të tjera të vendit do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive aventuristike dhe në ndërgjegjësimin ambiental të rinisë.</p> <p>Përveç aktiviteteve të përmendura më lart, mund të shtohen edhe disa workshope dhe aktivitete të tjera që mund të ofrojnë një gamë më të gjerë të mundësive për të rinjtë në Bashkinë Shkodër. Këto aktivitete ofrojnë një mundësi të shkëlqyer për të rinjtë për të marrë pjesë në jetën shoqërore, për të zhvilluar aftësitë e tyre dhe për të kontribuar në komunitetin e tyre. Bashkia Shkodër mund të shfrytëzojë këto iniciativa për të inkurajuar përfshirjen dhe angazhimin e rinisë në ndërtimin e një shoqërie më të fortë dhe më të përfshirë.</p> <p>Me disponimin e këtij buxheti të veçantë për rininë, të rinjtë e Bashkisë Shkodër do të kenë mundësinë e krijimit dhe realizimit të aktiviteteve të tyre të preferuara dhe të nevojshme për zhvillimin e tyre personal dhe kontributin në komunitet. Aktivitetet e propozuara janë tërheqëse dhe mund të kenë një impakt të madh në angazhimin dhe zhvillimin e rinisë në Bashkinë Shkodër. Këto aktivitete mund të ofrojnë një platformë të vlefshme për të rinjtë për të shfaqur talentet e tyre, për të përfshirë komunitetin dhe për të ndikuar në zhvillimin e qytetit në mënyra pozitive. Shqyrtimi i tyre:</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Tejkalmimi i sfidave financiare duke përcaktuar dhe implementuar një buxhet të veçantë për rininë në Bashkisë Shkodër. • Përfshirja dhe mobilizimi i rinisë në jetën shoqërore dhe kontributin në zhvillimin e komunitetit të tyre. • Krijimi i një platforme për shfaqjen dhe zhvillimin e talentit të rinisë nëpërmjet aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe vullnetare. • Ndikimi në zhvillimin e qytetit të Shkodrës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të tij përmes përfshirjes së rinisë në projekte dhe aktivitete të ndryshme. • Kultivimi i ndjenjës së përgjegjësisë sociale dhe solidaritetit në mesin e rinisë përmes organizimit të aktiviteteve vullnetare dhe projekteve me impakt pozitiv në komunitet. Inkurajimi i krijimit dhe realizimit të aktiviteteve të preferuara të rinisë nëpërmjet organizimit të eventeve të specializuara si Dita Ndërkombëtare e Rinisë dhe Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit. • Promovimi i eskursioneve rinore si një mënyrë për të eksploruar natyrën, për të ndërtuar lidhje të reja dhe për të përjetuar përvoja të reja në mjediset natyrore dhe qytetet e tjera të vendit. • Organizimi i workshopeve dhe aktiviteteve të tjera që ofrojnë një gamë më të gjerë të mundësive për të rinjtë në Bashkinë Shkodër për të zhvilluar aftësitë e tyre dhe për të marrë pjesë në jetën shoqërore. 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Organizimin e Dites Ndërkombëtare të Rinisë, duke përfshirë lojëra sportive, konkurse artistike, punëtori kreative dhe koncerte me artistë të rinj. • Mbajtjen e Dites Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, duke përfshirë fushata të pastrimit të mjedisit, ndihmën për të moshuarit dhe organizimin e aktiviteteve bamirëse. • Organizimin e eskursioneve rinore në zonat natyrore të bukura dhe në qytete të tjera të vendit. • Zhvillimin e workshopeve të ndryshme për të rinjtë, duke përfshirë workshopet kreative, trajnime sportive, seminare për zhvillim personal dhe profesional, dhe aktivitete të tjera të ngjashme. • Promovimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike të organizuara nga të rinjtë, duke përfshirë ekspozita të artit, performanca teatrale, dhe shfaqje muzikore. 		
b) Rezultatet që prisni		

<ul style="list-style-type: none"> Rritja e pjesëmarrjes së rinisë në aktivitete të ndryshme komunitare dhe krijimi i një kulture të përfshirjes dhe angazhimit të tyre në jetën shoqërore. Zhvillimi i aftësive të ndryshme të rinisë, duke përfshirë aftësi komunikimi, aftësi kreative, aftësi udhëheqëse, dhe ndërgjegjësimin e tyre për ndikimin pozitiv në komunitetin e tyre. Krijimi i një mjedisi të inkurajueshëm për të rinjtë për të shfaqur dhe zhvilluar talentet e tyre nëpërmjet aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe vullnetare. Përmirësimi i imazhit dhe identitetit të qytetit të Shkodrës si një qytet që vlerëson dhe promovon angazhimin e rinisë në zhvillimin e komunitetit. Rritja e ndërgjegjësimit social dhe solidaritetit në mesin e rinisë, duke promovuar vlerat e përgjegjësisë dhe kontributit në të mirën publike. Ndikimi pozitiv në cilësinë e jetës së banorëve të qytetit të Shkodrës nëpërmjet krijimit të më shumë mundësive për argëtim, zhvillim personal dhe pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore. 					
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt financiarisht etj.)		
Të rinjtë e Bashkisë Shkodër Komuniteti OJF Universiteti i Shkodrës			Bashkia e Shkodrës Donatorë të mundshëm		
e) Shpenzime të llogaritura					
Shpenzimet për aktivitetet rinore 2024		Totali (mijë lekë)			
		Nga kjo:			
A.1	Zhvillimi i Aktiviteteve		Paga Sigurime	Operative	Transferime
	Shuma	1,000		1,000	
		1,000,		1,000	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Sektori Rinise			
Gjatë vitit 2024		Drejtoria e Pergj. Sherbimeve Sociale			
		Institucioni Iikujdues: Bashkia Shkoder			

Nr. 29	P08130.Q1.O1.A15 Shkodra Qyteti Evropian i Sportit 2025	Funksioni 8: Argëtim, Kultura dhe Feja NN/Funksion 081: Sport dhe argëtim Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Bashkia e Shkodrës ka paraqitur kandidaturën për të qenë "Qyteti Evropian i Sportit" 2025. Ky titull përfaqëson një cmim që i ndahet qyteteve të Evropës nga ACES Evrope (Federata Evropiane e Kryeqyteteve dhe Qyteteve të Sportit), duke u bazuar në parimet e përgjegjësisë dhe etikës. Kjo njohje i jepet qyteteve të cilat e kuptojnë dhe e promovojnë rolin e sportit si një faktor bashkues në shoqëri, për të përmirësuar cilësinë e jetës, mirëqenien psiko-fizike dhe për të ndihmuar në integrimin e plotë të klasave sociale brenda komunitetit.</p> <p>Federata Evropiane e Kryeqyteteve dhe Qyteteve të Sportit (ACES) është një organizatë jo-fitimprurëse me qendër në Bruksel, e cila punon që prej vitit 1999 për të nxitur sportin tek të gjithë qytetarët e Bashkimit Evropian. Qëllimi kryesor i ACES është të promovojë sportin dhe aktivitetet sportive për të gjitha grupet e popullsisë, duke përfshirë grupe të pafavorizuara, fëmijë, pleq, dhe ata me aftësi të kufizuara. Përveç aspektit profesional të sportit, ACES synon të krijojë një platformë për bashkërendimin social, duke e konsideruar sportin si një mjet për të përmirësuar shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. "Qyteti Evropian i Sportit" është një iniciativë që ka marrë njohje nga Komisioni Evropian. Përveç kësaj, ACES Evrope është një partner zyrtar i Komitetit Evropian në Javën Evropiane të Sportit. Po ashtu, ACES Evrope është partner zyrtar i UNESCO-s, Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë. Titulli "Qyteti i Sportit" për vitin 2025 do të japë mundësi për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohje Ndërkombëtare: Duke e bërë Shkodrën "Qyteti i Sportit" në nivel evropian, ky titull do të misë vizibilitetin dhe prestigjin ndërkombëtar të qytetit. • Trashëgimi Sportive: Qytetet fituese ofrojnë një platformë më të mirë për pjesëmarrjen në aktivitete sportive për qytetarët e tyre në të ardhmen, duke e përhapur kulturën sportive. • Pjesëmarrje në një rrjet aktiv: Ky titull hap mundësinë për shkëmbimin e praktikave më të mira me qytete të tjera në Europë për promovimin e sporteve dhe aktiviteteve sportive, si dhe për të përmirësuar politikat vendore në sport. • Granta nga BE-ja: Përfshirja e këtyre qyteteve në projekte dhe thirrje të ndryshme të Bashkimit Evropian, ofron mundësi për të përfutuar nga fonde dhe grante për zhvillimin e projekteve sportive në komunitet. <p>Aplikimi për këtë kandidaturë udhëhiqet nga rregullorja e ACES "Rregullat e Përgjithshme që Udhëheqin Procesin e Përzgjedhjes së Kryeqytetit, Komunitetit, Qytetit dhe Rajonit Evropian të Sporteve", e cila është miratuar me 1 Dhjetor 2022. Bashkia e Shkodrës angazhohet të ndjekë të gjitha hapat e përcaktuara në këtë rregullore dhe të mbulojë pagesat që duhet të bëjë gjatë procesit të aplikimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pagesa e tarifës së aplikimit: 2,844 Euro (Artikulli 22.1 i Rregullores) • Pagesa për të drejtën e imazhit: 10,000 Euro (Artikulli 26.4 i Rregullores) • Kostoja e mikëpritjes për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit ACES Evrope: 12,300 Euro (akomodim, qëndrim, transport, dhe shpenzime udhëtimi për përfaqësuesit e Komitetit të Vlerësimit prej 4-6 anëtarësh, gjatë vizitës 3 ditore në Shkodër) (Appendix I) <p>Qyteti kandidat mban kostot/programin e mikëpritjes për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të ACES Evrope (akomodim/qëndrim/transport/shpenzime udhëtimi për përfaqësuesit e Komitetit të Vlerësimit prej 4-6 anëtarësh, detyrim ndaj ACES Evrope) - arrija e Komisionit të ACES Evrope në Shkodër mund të ndodhë në Gusht 2024, vendimi përfundimtar i Komitetit të Vlerësimit të ACES Evrope rreth 15-20 ditë pas vizitës në Shkodër.</p> <p>Për këtë arsye lind e nevojshme parashikimi i një fondi për mbulimin e shpenzimeve në zërat e buxhetit vjetor dhe afatmesëm.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Të parashikojë fondin për mbulimin e shpenzimeve në kuadër të shpalljes së kandidaturës së Bashkisë Shkodër si "Qyteti Evropian i Sportit" 2025, në zbatim të rregullores ACES "Rregullat e Përgjithshme që Udhëheqin Procesin e Përzgjedhjes së Kryeqytetit, Komunitetit, Qytetit dhe Rajonit Evropian të Sporteve", miratuar me datë 1 Dhjetor 2022.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
1. Bashkia Shkodër do të pëmbushë detyrimet financiare që rrjedhin nga aplikimi i saj në "Qyteti Evropian i Sportit" 2025.		
b) Rezultatet që prisni		

<ul style="list-style-type: none"> - Ngritje e kapaciteteve institucionale; - Promovimi i sportit dhe aktiviteve sportive; - Inkurajimi i një stili të jetesës aktive dhe shëndetësore nëpërmjet sportit. - Përfshirje e Bashkisë Shkodër në nisma evropiane. 						
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)			
Bashkia Shkodër Delegacioni i Bashkimit Evropian			Bashkia Shkodër Programet e BE-së Shoqata ndërkombëtare Donator të tjerë			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Vlera e mbulimit të shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë Shkodër për aplikimin "Qyteti Evropian i Sportit" 2025, përfshi edhe mbulimin e TVSH-së.	288				288
A.2	Vlera e mbulimit të shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë Shkodër për të drejtën e imazhit.	1,014				1,014
A.3	Vlera e mbulimit të shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteve.	1,247			1,247	
	Shuma	2,549			1,247	1,302
f) Periudha e zbatimi Gjatë vitit 2024			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kulturës Arsimit dhe Sporteve. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër			

Nr.30	P09230.Q1.O1.A26 Mbeshtetje e Trajtimin të Studentëve sha. Shkodër	Funksioni 9: Çështje ekonomike N/Funksioni 092: Arsimi Programi 09230: Arsimi i mesëm i përgjithshëm			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:					
i. Situata					
<p>Trajtimi i Studentëve sha Shkodër është krijuar në vitin 1991 dhe është themeluar si SH.A në vitin 2005, me kapital 100% shtetëror dhe kapital themeltar 157,323,000 lekë, i ndarë në 157,323 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secili, me aksioner të vetëm Ministrinë e Financave. Në vitin 2020, me VKM nr. 350 është transferuar 100% në pronësi të Bashkisë Shkodër, e cila është edhe aksionarja e vetme. Trajtimi i Studentëve sha Shkodër, është ndërmarrje me interes publik, e cila përfshihet në institucionet e arsimit të lartë, dhe ka për qëllim të veprimtarisë së saj, Furnizim dhe trajtim i studentëve me ushqim, fjetje dhe shërbime të tjera hotelerie, Furnizim dhe trajtim i personave të ftuar apo vizitorë, persona të treta jo student, delegacione apo personalitete të huaj apo Shqiptar, me fjetje dhe shërbime të tjera hotelerie, sipas kërkesës, sipas nevojës së Bashkisë Shkodër, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke kryer çdo operacion tregtar dhe financiar të nevojshëm, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e Shoqërisë, etj.. Nga viti 2020 deri në vitin 2023, ndërmarrja ka pasur një përmirësim relativ të, përsa i përket numrit të studentëve të akomoduar, duke patur parasysh edhe situatën pandemike të kohës dhe pasojat e mëtejshme, kushtet financiare etj.</p> <p>Me synimin e përmirësimit të situatës, rritjes së numrit të studentëve për akomodim, tërheqjen e personave të tretë dhe zgjerimin e fushës së interesit për akomodim në ndërmarrje brenda periudhës 2024-2025, Bashkia Shkodër do të mbështesë Trajtimin e Studentëve sha.</p>					
ii. Synimi i projektit					
<ul style="list-style-type: none"> • Për periudhën 2024-2025, rritja e numrit të studentëve për akomodim • Shfrytëzimi i kapaciteteve tona nëpërmjet zgjerimit të fushës së akomodimit nga persona të tretë (jo studentë). • Rritja e cilësisë dhe zgjerimit të shërbimeve të ofruara • Përmirësimi i kushteve në godina 					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit					
<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i financimit të pagave/shpërblimeve për stafin e ndërmarrjes prej 22 punonjësish, me paga bruto mujore 958,300 leke dhe kontribute shoqërore e shëndetësore prej 160,036 leke. • Sigurimi i financimit për shpenzimet e shfytëzimit, furnitura (energji elektrike, uje, EKR, etj) • Sigurimi i investimeve për godinat e ndërmarrjes, investim në mjete hidrike, elektrike, ngrohje, fasada etj; • Sigurimi i kushteve optimale të akomodimit, nëpërmjet mirëmbajtjes së ambienteve të godinave, garantimit të bazës materiale, etj. 					
b) Rezultatet që prisi					
<ul style="list-style-type: none"> • Tërheqjen dhe rritjen e numrit të personave të akomoduar • Përmes realizimit të objektivave të parashikuara, synohet nxitja dhe rritja e numrit të studentëve për të frekuentuar ambientet tona, zgjerimi i fushës së interesit për persona për akomodim. • Përmirësimi i klimës administrativo-financiare. 					
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt		
Trajtimi i Studentëve sha, Bashkia Shkodër, Ministria e Arsimit dhe Sportit, donatorë.			Bashkia Shkodër, Ministria e Arsimit dhe Sportit, donatorë.		
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mije lekë)	Nga kjo:		
A.1	Mbeshtetje e Ndërmarrjes së Trajtimin të Studentëve.	16000	Paga	Sigurime	Operative
	Shuma	16 000			16 000
f) Periudha e zbatimit Gjate vitit 2024		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kultures Arsimit dhe Sportit. Institucioni likuidues : Bashkia Shkoder			

Nr.31	P04220.Q1.O1.A1. Trajtimi i qenve të rugës. (shtese)	Funksioni 04: Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia N/funksioni 042: Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja ndaj konsumatorëve Llojet e programit 04220: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
<p>Njësisë së Qeverisjes vendore sipas nenit 54 të ligjit nr. 10465: "Për Shërbimin Veterinar" ndër të tjera i lind detyra të kontrollojë dhe të zbatojë kërkesat e këtij ligji për kontrollin e kafshëve të shoqërimin (qenve dhe maceve). Situata në Bashkinë Shkodër të kafshëve të rugës imponon ndërhyrje në trajtimin veterinar të tyre me anë të sterilizimit dhe vaksinimit, si dhe strehimit per.nje pjesë të tyre. Meqënëse tashmë strehëza e qenve në Bashkisë Shkodër është funksionale, ku krahas strehimit po kryhet dhe paisja e klinikës veterinare si pjesë integrale e kësaj strehëze, bazuar kjo në Vendimin nr 75 datë 23.02.2024 Për miratimin e rishpërndarjes së fondit, brenda të njëjtit program për vitin 2024", lind nevoja e paisjes me një automjet të përshtatshëm për transportimin e qenve. Situata aktuale e qenve të rugës të strehuar në strehëz është 105 qen dhe pritet që ky numër të rritet në rreth 400 qen me ndërtimin e strehëzës së re. Përveç trajtimit dhe strehimit të qenve në strehëz do vazhdojë nga stafi i bashkisë dhe sterilizimi dhe vaksinimi i qenve të cilët nuk do strehon në këto strehëza.</p>							
ii. Synimi i projektit							
Trajtimi veterinar i kafshëve të rugës sipas ligjit "Për veterinarinë"							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
1. Blerje automjet për transport të qenve dhe paisjeve/mjeteve që lidhen me administrimin e strehëzës.							
b) Rezultatet që prisni							
Funksionim më efikas i strehëzes së qenve.							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP, Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër.				Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali 000(lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.5	Blerje Automjet për transport qen	1,000,					1,000
Shuma		1,000					1,000,
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Gjate vitit 2024			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtitit të AMTP. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër.				



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2024

RELACION

“Për një ndryshim në VKB nr. 55 datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024- 2026 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar ; të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, të ndryshuar ; Udhëzimit Plotësues i Ministrisë së Financave nr.1, datë 24.01.2024 “Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2024” Bashkia paraqet disa ndryshime në buxhetin e saj ku përfshihen shtesa, pakësime dhe rialokime të fondeve të trashëguara nga viti 2023.

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2023 realizoi të ardhurat e veta në masën 97.62 % me një mosrealizim nga të ardhurat e veta në shumën 20 780 mijë lekë e ndarë si më poshtë:

Ne mije leke

Nr	TE HYRAT DHE FINANCIMET NE LLOGARITE E THESARIT	Plani 2023	Fakti 2023	Diferenca
I	TE ARDHURAT E VETA	876,066	855,286	-20,780
	Të ardhura nga taksat vendore	348,913	303,651	-45,262
	Të ardhura nga taksat e ndara	127,757	166,877	39,120
	Te ardhura nga tarifat vendore	369,425	358,161	-11,264
	Të ardhura të tjera	29,971	26,597	-3,374

Zërat kryesorë, që janë me tejkalim në krahasim me planin e vitit 2023 janë të ardhurat nga taksa mbi ndërtesën, taksa mbi truallin, taksa e fjetjes në hotel, tarifat e pastrimit, tarifa e gjelbërimit, tarifa e parkimit, zënia e hapësirës publike që vijnë si rezultat i mbledhjes së detyrimeve aktuale po ashtu edhe atyre të prapambetura nëpërmjet bllokimit të llogarive të biznesit apo akt-marrëveshjeve për pagesë me këste.

Të ardhurat për këto zëra janë realizuar me tejkalim si rezultat i zgjerimit të bazës së taksapaguesve si efekt i rritjes së kontrollit në terren dhe konkretisht realizimit të **2578 akt-kontrolleve**, ushtrimit të masave shtrënguese ligjore me rreth **917** bllokime llogari bankare biznes dhe **1103** llogari bankare individ, **73** Urdhër Ekzekutime dhe **182** akt-marrëveshje për detyrimet e prapambetura. Gjithashtu sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i taksapaguesve nëpërmjet njoftimeve në media dhe në ëeb, nëpërmjet dërgimit të rreth **3640** njoftim-detyrimeve, përmirësimit të sistemit informatik SiTTV dhe lidhjes me Zyrën me I-Ndalesë, rivlerësimit të kategorive dhe aktivitetit të subjekteve, mbështetjes nga agjentët tatmorë etj.

Zërat ndikues me mosrealizim janë taksa e tokës bujqësore, si rezultat i mungesës së informacionit të plotë nga ASHK me pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën dhe taksapaguesin e taksës së tokës bujqësore. Këto diferencë në të ardhurat buxhetore totale plotësohen nga zëra të tjerë me tejkalim dhe kanë ndikuar në realizimin e mbledhjes së të ardhurave perafersisht në masën **98%** për Taksa & Tarifa dhe Grante.

Agjenti tatimor Ujësjellës Kanalizime sh.a vazhdon të jetë i bllokuar nga subjekte të treta, shoqëri përmbarimore në bankat e nivelit të dytë, Drejtoria e Tatimeve etj dhe si pasojë detyrimi që Ujësjellës Kanalizime sh.a ka ndaj Bashkisë Shkodër nuk është transferuar rregullisht në llogari të saj. Nga ana e Bashkisë Shkodër janë marrë masa për gjetjen dhe ndjekjen e rrugëve ligjore për transferimin e shumave përkatëse të palikjuara duke u bazuar në akt marrëveshjen e lidhur Ujësjellës Kanalizime sh.a. dhe korrespondencën me bankat e nivelit të dytë .

Prandaj pakësimi i planeve si rrjedhojë e mosrealizimit të të ardhurave të veta është në shumën 20 780 005 leke detajuar sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur projekt- vendimit.

Rishpërndarje në fondet e veta transfertë e pakushtezuar dhe të ardhura të veta, në shumën 295 103 157 lekë, teprica nga viti i kaluar 294 271 846 leke si dhe 831 311 leke nga buxheti i vitit 2024, do të bëhet sipas kërkesave buxhetore të paraqitura nga drejtuesit e programeve, të dakordësuara nga Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe të bashkëlidhura me këtë relacion.

I. Investime ne rruge urbane dhe rurale

Në vijim të buxhetit të vitit 2024 te miratuar me Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026”, të ndryshuar, paraqesim relacionin argumentues për buxhetin shtesë dhe kërkesën për 3 investime të rëndësishme të cilat kanë impakt në zonat ku aplikohen dhe jo vetëm.

Gjithashtu, kërkojmë që të parashikohet një vlerë për likuidimin e tarifave/taksave për aplikime apo shërbime në lidhje me projekte të Bashkisë Shkodër.

- Investimet janë si më poshtë:

1. Rikonstruksion rruga e 'Foljetave', Bashkia Shkodër

Ky rikonstruksion konsiston në ndërhyrjen në rrugën e 'Foljetave' e cila ndodhet në Lagjen nr. 4. Zona e ndërhyrjes kufizohet me rrugën "Draçin" në anën veriore dhe lidhet me rrugën "Smajl Nikoçi" në anën jugore. Ky segment që të lidh me Unazen Lindore ka një gjatësi 257 ml. Rruga është e rrethuar me shtëpi private dhe i shërben banorëve të zonës për akses optimal me infrastrukturën e qytetit.

Ky projekt ka parashikuar punime për trupin e rrugës me të gjithë elementet e nevojshëm për krijimin e kushteve optimale në shërbim të komunitetit.

Projekti dhe preventivi për fazën e zbatimit do të hartohen në tërësi duke përfshirë si infrastrukturën rrugore ashtu dhe infrastrukturën nëntokësore si : punime në trupin e rrugës, punime shtresash, punime në rrjetin e kanalizimeve të ujrave të bardha, të ujrave të zeza, ujësjellësit, ndriçimit rrugor dhe punimeve të sinjalistikës. Rikonstruksioni i rrugës synon në krijimin e hapësirave për funksionimin e rrugës sipas standarteve dhe lidhjen e saj me hapësirat përreth. Përfituesit direkt të projektit janë banorët e zonës përreth.

Bashkëlidhur fisha-projekti P04520.Q1.O2.A10.Rikonstruksion rruga e 'Foljetave', Bashkia Shkodër me vlerë 8,400,000 lekë.

2. Sistemim Asfaltim rruga e varrezave të qytetit "Fshati Golem", Bashkia Shkodër

Ky rikonstruksion konsiston në ndërhyrjen në rrugën e varrezave që ndodhet në njësinë administrative Rrethina, fshati Golem. Ky segment i cili të lidh me varrezat e qytetit ka një sipërfaqe 3350 m² dhe përbëhet nga rruga lineare e cila përfundon tek sheshi sipas hartës. Kjo rrugë i shërben banorëve të zonës dhe qytetit për akses optimal në parcelat e varrezave.

Ky projekt ka parashikuar punime për trupin e rrugës me të gjithë elementet e nevojshëm për krijimin e kushteve optimale në shërbim të komunitetit.

Projekti dhe preventivi për fazën e zbatimit do të hartohen në tërësi duke përfshirë si infrastrukturën rrugore ashtu dhe infrastrukturën nëntokësore si : punime në trupin e rrugës, punime në rrjetin e kanalizime të ujrave të bardha, punime për trotuarin, punime sinjalistike.

Rikonstruksioni i rrugës synon në krijimin e hapësirave për funksionimin e kësaj zone, lidhjen e saj me hapësirat përreth.

Përfituesit direkt të projektit janë të gjithë banorët e qytetit Shkodërs si dhe të njësive administrative. Bashkëlidhur fish-projekti P04520.Q1.O3.A5.Sistemim Asfaltim rruga e varrezave të qytetit "Fshati Golem", Bashkia Shkodër me vlerë 11,248,000 lekë.

3. Sistemim Asfaltim rruga 'Pjetrushit' pranë varrezave të qytetit, Grudë e Re, Bashkia Shkodër

Ky rikonstruksion konsiston në ndërhyrjen në rrugën 'Pjetrushit' që ndodhet në njësinë administrative Rrethina, fshati Grude e Re. Ky segment që të lidh me varrezat e qytetit ka me gjatësi 740 ml përbëhet nga rruga që lidh segmentin e

parë të rr. 'Pjetrushë me rrugën 'Kuvendi''. Rruga i shërben banorëve të zonës për akses optimal në parcelat e varrezave të qytetit.

Ky projekt ka parashikuar punime për trupin e rrugës me të gjithë elementet e nevojshëm për krijimin e kushteve optimale në shërbim të komunitetit.

Projekti dhe preventivi për fazën e zbatimit do të hartohen në tërësi duke përfshirë si infrastrukturën rrugore ashtu dhe infrastrukturën nëntokësore si : punime në trupin e rrugës dhe punime sinjalistike. Në rikonstruksion do të përfshihet dhe ndërtimi i një muri në pjesën perëndimore për bllokimin e aksesit si dhe do të parashikohen vendosja e 6 çezmeve ndërmjet parcelave të varrezave në fuksion të pastrimit të tyre. Rikonstruksioni i rrugës synon në krijimin e aksesit të banorëve ndërmjet fshatërave Grudë, Grudë e Re, Golem dhe jo vetëm. Përfituesit direkt të projektit janë të gjithë banorët e njësisë administrative Rrethina.

Bashkëlidhur fisha-projekti P04520.Q1.O3.A6. Sistemim Asfaltim rruga 'Pjetrushë' pranë varrezave, Grudë e Re, Bashkia Shkodër me vlerë totale 27,768,000 lekë, nga të cilat 999,000 lekë Shpenzime Kapitale Të Patrupëzuara dhe 26,769,000 lekë Shpenzime Kapitale Të Trupëzuara.

4. Tarifa/taksa për aplikime apo shërbime në lidhje me projekte të Bashkisë Shkodër

Me këtë zë buxhetor parashikohen të mbulohen të gjitha tarifat dhe taksat pranë institucioneve të ndryshme të nevojshme për miratimin e lejeve për projektet për të cilat është përgjegjëse Bashkia Shkodër.

Këto përfshijnë (por nuk limitohen vetëm në to):

- tarifat e oponencës për projektet e veprave të ndërtimit, në përputhje me Ligjin nr.8402, Datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe VKM Nr. 9, Datë 11.1.2024 "Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste",
- tarifat e aplikimit dhe të miratimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, në përputhje me Ligjin Nr.10 440, Datë 7.7. 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar,
- tarifat e aplikimit dhe të miratimit të autorizimeve pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, në përputhje me ligjin Nr 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", i ndryshuar.

Grupimi i këtyre shpenzimeve në një zë buxhetor thjeshton procedurat operative, rrit fleksibilitetin për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara dhe shkurton kohën e nevojshme për miratimin e lejeve dhe autorizimeve nga institucione të ndryshme.

Bashkëlidhur fisha-projekti P06140 .Q1.O1.A6 Tarifa/taksa për aplikime apo shërbime në lidhje me projekte të Bashkisë Shkodër me vlerë 5,000,000 lekë (shpenzime operative).

II. Shërbime Publike të realizuara nga Ndermarrja e Shërbimeve dhe Puneve publike

Në vijim të buxhetit të vitit 2024, miratuar me VKB nr 55, datë 29.12.2023, paraqesim relacionin argumentues për buxhetin shtesë për të shtuar shërbimet nga Ndërmarrja e Sherbimeve dhe Puneve publike për vitin buxhetor 2024.

Kërkesat konsistojnë si më poshtë:

1. Në programin P04240.Q1.O1.A4 kërkojmë një fond për blerjen e një mjeti teknologjik për “Pastrimin e kanaleve kulluese dhe ujitëse” nga bimesia e gjelbërt.

Sektorit I Kullim -Ujitjes punon sipas një plani të ardhur nga Bashkia për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve. Në Bashkinë Shkodër kemi aktualisht 836 km kanale kulluese dhe vaditëse. Sipas standarteve dhe normativave , këto kanale duhet të pastrohen një herë në tre vite. Aktualisht mirëmbajmë dhe pastrojmë rreth 15% të kanaleve. Shkaku kryesor i këtij problemi ,është bimësia e gjelbert, kallamat dhe shkurret që dalin dy here në vit. Në kushtet aktuale , kur kemi vetem dy eskavator me zinxhir është e pamundur mirembajtja e kanaleve , pastrim I bimesisë së gjelbërt.

Duke blerë këtë mjet teknologjik rritet efiçenca e kanaleve të pastruar, si dhe me mjetet e tjera gërmuese që kemi blerë , ne mund të futemi në realizimin e ciklit të plotë të pastrimit të 80% të kanaleve ujitëse dhe kulluese, mbrenda një viti.

Ky mjet teknologjik është multifunksional, ka një system montimi të pajisjeve të ndryshme, për pastrim dëbore, për punime kantjeri, për krasitje pemesh.

Me mjetet gërmuese që kemi blerë të arrijmë të futemi ne ciklin e plotë te pastrimit të kanaleve, sipas standarteve.

Bashkëlidhur fisha-projekti P04240.Q1.O1.A4 - Pastrim kanalesh kulluese në Nj.A. (shtesë) me vlerë 18,000,000 lekë (Shpenzime Kapitale të Trupëzuara).

2. Në progamin P04240.Q1.O1.A3 “ Menaxhimi i Ujitjes dhe Kullimit”.

Në aktivitetin të këtij programi ”Shpenzime për qeramarrje mjeti transporti”, kërkojmë një shtesë prej 405,000 lekë. Parashikimi fillestar në buxhetin e 2024, ka qenë vetëm për mjetet e Sektorit të Kullim-Ujitjes, eskavatoret me zingjir. Këto mjete e kanë të pamundur dhe të palejuar lëvizjen nga njëri objekt në tjetrin, pasi janë mjete me zingjir dhe dëmtojnë infrastrukturën rrugore. Për këtë është e domosdoshme lëvizja e tyre me mjetin me qera që ka remorkiator. Meqenëse Ndërmarrja jonë ka rritur numrin e mjeteve në funksion të detyrave të veta,, mjete që dhe këto duhet të lëvizin me rimorkiator, kërkojmë këtë buxhet shtesë, për të përballuar transportin e këtyre mjeteve sipas nevojave tona.

Bashkëlidhur fisha-projekti P04240.Q1.O1.A3 - Menaxhimi dhe funksionimi i sektorit te kullimit dhe ujitjes (shtesë) me vlerë 405,000 lekë (Shpenzime Operative).

3. Në programin P04520.Q1.O1.A3 “Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës”.

Kemi kërkesa për tre aktivitete :

- a) Në aktivitetin A1 të këtij programe për “ Blerje materiale ndertimi per mirembajtjen e rrugeve dhe trotuareve qytet dhe NJ.A, kërkojmë një shtesë prej 10,000,000 lekë. Kjo shtesë buxheti për blerje baze materiale, pasi

mënyja e organizimit të Ndërmarrjes, për kryerje të shërbimit të mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve nga vetë punonjësit e Ndërmarrjes ka kriju mundësi për një rritje të konsiderushme të sasisë , volumit të punimeve. Për të realizuar këtë mundësi , të rritjes së shërbimeve të mirëmbajtjes , kërkohet shtimi i bazës materiale. Prandaj kërkohet ky buxhet shtesë, si një arsye e rritjes së performancës së shërbimeve sipas këtij organizimi të ri , me Ndërmarrje Shërbimi.

- b) Në kuadër të lirit të hapsirave publike në Shiroke, është bërë e mundur të kemi për përdorim një sipërfaqe të konsiderushme në dispozicion.

Duke patur në konsideratë problematikat e mëdha të parkimit të mjeteve në këtë zonë, është vendosur që kjo hapsirë e lirë të bëhet parking mjeteve.

Për këtë arsye kërkohet të blihet bazë materiale, që me puntorët e ndërmarjes sonë ,të realizohen punimet për të vënë në eficence këtë hapsirë si parking. Buxheti që kërkohet është 20,000,000 lekë.

- c) Meqenëse kemi një rritje të flusksit të njerëzve , por në të njëjtet kohë ka dhe lëvizje të pakontrolluar të mjeteve, gjë që bën të domosdoshëm vendosjen e barrierave kufizuese të lëvizjes. Është e domosdoshme blerja e pistonëve dhe e trarëve për kufizim lëvizje , me një fond prej 5,000,000 lekë.

Bashkëlidhur fisha-projekti P04520.Q1.O1.A3 Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës (shtesë) me vlerë totale 35,000,000 lekë (Shpenzime Operative).

4. Në programin P06260.Q3.O1.A7 kërkojmë një fond për “Rikonstrukcion magazine dhe ambienteve të jashtme”.

Krijimi i Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike, si dhe akomodimi i saj tek ish ambientet e Ujësellsit , kërkon nga ana organizative domosdoshmërine e një magazine. Vete metodologjia e punëve operative për ndërhyrje të menjëhershme kërkon të paturit e bazës materiale në gjendje.

Gjithashtu dhe mjetet në dispozicion të punonjësve duhet të kene kushte normale të ruajtjes.

Për këtë arsye lind nevoja e të paturit të një magazine në kushte optimale. Aktualisht , ekziston një strukture ndërtimore për magazine por që është e amortizuar plotësisht. Kërkohet fondi prej 9,200,000 lekësh për rikonstrukcionin e kësaj magazine si dhe për organizim sistemim ambientësh të jashtme .

Bashkëlidhur fisha-projekti P06260.Q3.O1.A7 Rikonstrukcion ambiente magazine dhe të jashtme me vlerë 9,200,000 lekë (Shpenzime Kapitale të Trupëzuara).

5. Në programin P06260.Q2.O1.A2 tek “Mirembajtja e sipërfaqeve ujore”, kërkojmë një fond për “Pastrim liqeni , marrje me qera makinerie dhe sinjalistikë,” me një vlerë prej 10,000,000 lekë.

Historia e lumit Buna ka një rëndësi të madhe në peisazhin gjeografik të Qytetit. Si një rrugë ujore vendimtare që buron nga veriu i vendit dhe derdhet në detin Adriatik, lumi Buna ka luajtur një rol kryesor në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të rajoneve perreth. Duke eksploruar kontekstin historik të lumit Buna dhe liqenit të Shkodrës ne mund të fitojmë njohuri të vlefshme dhe të pasur të historisë tonë e cila ndërlihdet me botën e gjere mesdhetare.

Në lumin Buna prej shumë vitesh nuk është vënë dorë për pastrimin nga aluvionet e mbetura. Kalimi i mjeteve lundruese ,gjatë lëvizjes në linjen Ura e Bunës - Shiroke kërkon që rruga e lundrimit të mbahet pastër dhe lehtësisht e kalushme. Sot në kohë vere uji zbret në nivele minimale duke u ulur deri në nivelin 0.5m, gjë që lundrimi bëhet i vështirë edhe për mjete të vogla lundruese. Në një gjatësi prej 3.5 km në total, problematike është pastrimi dhe largimi i aluvioneve. Ky pastrim mundëson zhvillimin e turizmit nga Ura e Bunës deri tek liqeni i Shkodres dhe mëtej. Realizimi i këtij pastrimi kërkon mjete të pershtatshme për këtë lloje procesi si: Puntone, Eskavator me krahe të gjatë, Mjete transporti, Drage me tubacione, Mjete korrese bari në prezencë uji për hapjen e shtigjeve të lundrimit.

Bashkëlidhur fisha-projekti P06260.Q2.O1.A2. Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve ujore (shitesë) me vlerë 10,000,000 lekë (Shpenzime Operative).

6. Në programin P06260.Q3.O1.A8, kërkojmë një fond prej 1,000,000 lekë për “ Tualete publike në pika turistike”.

Në fuksion të përmisimit të përformancës së zhvillimit të turizmit , një domosdoshmëri është dhe të paturit në disa pika të rëndësishme turistike të tualeteve publike.

Për këtë kemi menduar që të marrim me qera rreth 12 tualete të tilla dhe ti shpërndajmë sipas rëndësisë në tre apo katër vende të ndryshme.

Ky investim rritë mjaftueshëm standartin e një turizmi elitari, krijon premisa për rritjen e numrit të turistëve vendas dhe të huaj.

Bashkëlidhur fisha-projekti P06260.Q3.O1.A8 Tualete publike, pika turistike me vlerë 1,000,000 lekë (Shpenzime Operative).

7. Në programin P04130.Q3.O2.A2 Përmirësim i infrastrukturës dhe shërbimeve në plazhe dhe në destinacione të tjera turistike. (Zhvillimi i turizmit)

Në vitet e fundit, ka pasur një rritje të vazhdueshme të numrit të turistëve që vizitojnë Shkodrën dhe qyteti po bëhet gjithnjë e më i njohur si një destinacion turistik i rëndësishëm në Shqipëri. Përmirësimi i aksesit dhe shërbimeve me qëllim zhvillimin e turizmit në Shkodër është një proces i rëndësishëm pasi kontribuon në ndërtimin e një destinacioni turistik më tërheqës dhe të qëndrueshëm. Për këtë Bashkia Shkodër realizon nderhyrje të vazhdueshme në zonat turistike, në veçanti në ato zona që kanë një numër të lartë vizitorësh. Velipoja është kthyer në një qendër të rëndësishme për turistët që e zgjedhin atë si destinacion bregdetar. Duke parë fluksin e lartë të frekuentimit që ka plazhi i Velipojës propozohen ndërhyrje të lehta në infrastrukturen dhe shërbimet mbështetëse të cilat do të jenë në ndihmë të pushuesve në plazhet publike dhe në shëtitoren e Velipojës. Ndërtimi i disa shkallareve që lidhin banesat dhe hotelet me pedonalen e Velipojës dhe plazhin si dhe vendosja e pedanave që përmirësojnë aksesin në plazh do të jenë dy ndërhyrjet e planifikuara të cilat do të rrisin cilësinë e frekuentimit të këtij plazhi. Gjithashtu, Bashkia Shkodër për zonën e Velipojës, ka planifikuar rritjen e sipërfaqeve publike duke krijuar akses për të gjithë vizitorët që duan të shfrytëzojnë këto hapsira. Në kuadër të mirëfunksionimit të këtyre hapsirave dhe evidentimit sa më të mirë të tyre propozohet vendosja e tabelave informuese që orientojnë vizitorët drejt këtyre plazheve publike. Gjithashtu për të pasur sa më të qartë hapsirat e shfrytëzimit të plazheve midis publikut dhe privatit por edhe për të krijuar një mjedis sa më të këndshëm dhe të rregullt parashikohet edhe vendosja e piketave për plazhet publike me frekuentim më të

lartë. Për këto plazhe në zbatim dhe të detyrimeve ligjore duhet bërë pastrimi i saj përpara fillimit të sezonit. Për realizimin e lëtij pastrimi në mënyrë më të thjeshtuar dhe cilësore kërkohet marrja me qira e mjetit që realizon pastrimin e kësaj sipërfaqeje rënore.

Bashkëlidhur fisha-projekti P04130.Q3.O2.A2 Përmirësim i infrastrukturës dhe shërbimeve në plazhe dhe në destinacione të tjera turistike me vlerën 1,500,000 lekë, e financuar nga Bashkia Shkodër.

III. Investime dhe Mirëmbajtje në godina publike

Kërkesat konsistojnë si më poshtë:

1. Në programin P08130.Q1.O2.A7 Furnizim vendosje dhe blerje materiale Pallati i Sportit

Bashkia e Shkodrës është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të saj në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bazuar në ligjin Nr. 139/2015, datë 17. 12. 2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 25 ‘Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese’, pika 4 : Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Në funksion të organizimit të ri , në Drejtorinë e Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike , ku rritja e burimeve njerëzore ,mjeteve standarde si dhe atyre teknologjike, kanë krijuar kushtet për rritjen e volumit të shërbimeve si dhe të një efijence me të mirë të këtyre shërbimeve. Në këto kushte është rritur mundësia e kryerjes se shërbimeve të mirëmbajtjes së godinave publike, por që duhet të shoqërohet me rritjen e bazës materiale që shërben për këtë qëllim. Prandaj lind nevoja e rritjes së buxhetit për blerjen e bazës materiale, për realizim maksimal të shërbimit të mirëmbajtjes.

Njëkohësisht, në kushtet e nevojës së rehabilitimit të ambienteve të ndryshme të institucioneve sportive për rikualifikimin e tyre , të cilat shume shpesh gjenden të amortizuara dhe me prani të thekuar lagështire, dëmtimesh të ndryshme, apo dhe të pajisjeve të dëmtuara .

Synimi është:

-Krijimi kushteve optimale të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike për realizimin në rritje të detyrave .

-Realizimi i punimeve të mirëmbajtjes së institucioneve sportive nga punonjësit e vete drejtorisë së përgjithshme

-Krijimin e institucioneve sportive me të shëndetshëm, me të përshtatshme për aktivitetet sportive si dhe me pritëse për publikun

-Pajisja e Pallatit të sportit me ulëse, kosha, ndriçim , tabela të reja si dhe mirëmbajta e fushave të tjera sportive përpos asaj të Pallatit të Sportit.

Bashkëlidhur fisha-projekti P08130.Q1.O2.A7 Furnizim vendosje dhe blerje materiale Pallati i Sportit me vlerë 7,500,000 lekë ku detajimi i zërave, sasive dhe specifikimeve teknike do paraqitet në dokumentat e tenderit të blerjes.

2. Në programin P08130.Q1.O2.A6 Fusha të pambuluara sportive shkolla Xheladin Fishta.

Mungesa e një fushe poli sportive me ndriçim për zhvillimin e orëve të edukimit fizik apo dhe të aktiviteteve të ndryshme për gjithë nxënësit, pasi palestra është ambienti i vetëm sportiv dhe si i tillë i pa mjaftueshëm për të gjithë.

Përmasat e fushës të lejojnë mundësinë e zhvillimit të disa disiplinave sportive , këshillohet 20 x 30 metër.

Qëllimi është:

- Zhvillimi i rregullt i orëve të edukimit fizik për nxënësit e shkollës .
- Mundësie e shfrytëzimit të objektit si qendër komunitare në orët e pasdites, duke u shfrytëzuar nga i gjithë komuniteti.
- Instalimin e ndriçimit , kanalizimeve dhe ambienteve të tjera rekreative në këto institucione arsimore.
- Mundësie e përdorimit të ambienteve sportive gjatë gjithë harkut ditor me ndriçimin e ri nga nxënësit dhe banoret e zonës.
- Mundësie e zhvillimit të orëve të edukimit fizik për të gjithë klasat njëkohësisht.
- Rimodelimi i sheshit për krijimin e një hapësire më të përshtatshme për stafin dhe nxënësit dhe banorët gjatë orëve të pushimit dhe mësimin apo pasditeve.

Kosto Totale e Projektit	5,145,027
Kosto e zbatimit	5,000,000
Kosto e supervizim	128,694
Kosto Kolaudim	16,333
Kosto Projektim	0

Bashkëlidhur fisha-projekti P08130.Q1.O2.A6 Fusha të pambuluara sportive shkolla Xheladin Fishta me vlerë totale 5,145,027 lekë.

3. Në programin "P09120.Q1.O1.A30 Blerje materiale për mirembajtje tualete ,terrace, rrjete elektrike shkolla dhe kopshte." dhe
4. Në programin "P09320.Q1.O2.A7 Blerje materiale për mirëmbajtjen e tualeteve të shkollave të mesme."

Në kushtet e nevojës së rehabilitimit të tualeteve, të terracave të rrjete elektrike dhe hidrike, të institucioneve për rikualifikimin e tyre , te cilat shume shpesh gjenden te amortizuara dhe me prani te theksuar lagështire, dëmtimesh në suva , në hidrosanitare vlera e kërkuar për mirembajtje tualete ,terrace, rrjete elektrike shkolla dhe kopshte është 14,854,973 lekë dhe vlera e kërkuar për blerje materiale për mirëmbajtjen e tualeteve të shkollave të mesme është 6,500,000 lekë, ku detajimi i zërave, sasive dhe specifikimeve teknike do paraqitet ne dokumentat e tenderit te blerjes.

Bashkëlidhur fisha-projekti P09120.Q1.O1.A30 Blerje materiale per mirembajtje tualete ,terrace, rrjete elektrike shkolla dhe kopshte me vlerë 14,854,973 lekë.

Bashkëlidhur fisha-projekti P09320.Q1.O2.A7 Blerje materiale për mirëmbajtjen e tualeteve te shkollave te mesme me vlerë 6,500,000 lekë.

5. Në programin P09120.Q1.O3.A8 Instalimi i ngrohjes qendrore në shkollat 9 vjeçare.

Nevoja për instalimin e ngrohjeve qendrore në objektet arsimore 9 vjeçare si ku pas largimit të ngrohjes me soba me gaz hapi i radhës është ofrimi i sistemeve me ngrohje .Sistemet me ngrohje qendrore si sisteme me ekonomike , ekologjike krijojnë dhe nivele komfortit si dhe sigurie, me largimet e gazrave dhe tymit nga klasat. Po ashtu duke ofruar ngrohje edhe në gjithë ambientet e tjera përpos klasave.

Kostot e investimit do të jenë:

Kosto e zbatimit	28,787,600
Kosto e projektimit	824,130
Kosto supervizim	349,630
Kosto kolaudim	38,640
Kosto Totale e Projektit	30,000,000

Bashkëlidhur fisha-projekti P09120.Q1.O3.A8 Instalimi i ngrohjes qendrore në shkollat 9 vjeçare me vlerë totale 30,000,000 lekë.

6. Në programin P01110.Q3.O1.A15 Rikonstrukcion godina ish konvikti Safet Spahia

Nevojat për rikualifikimin e godinave dhe asetëve të Bashkisë Shkodër , për tu kthyer në shërbim të qytetarëve. Duke shmangur amortizimin dhe degradimin e tyre , si dhe duke rritur cilësinë e shërbimeve ndaj komunitetit.

Ndërtimin e zyrave te reja për administratën duke ri kualifikuar një godinë të amortizuar e cila ka vite që nuk përdoret. Duke kryer ndërhyrje thelbësore në gjithë godinën.

Kosto e investimit do të jenë:

Kosto e zbatimit	32,408,841
Kosto e projektimit	0
Kosto mbikëqyrje	0
Kosto kolaudim	0

Kosto Totale e Projektit 32,408,841

Bashkëlidhur fisha-projekti P01110.Q3.O1.A15 Rikonstruksion godina ish konvikti Safet Spahia me vlerë 32,408,841 lekë.

7. Në programin P08220.Q1.O3.A27 Instalimi i sistemit te ngrohjes dhe ftohjes Teatri Migjeni

Nevoja për instalimin e ngrohjes dhe ftohjes qendrore në një objekt të rëndësishë së veçantë si Teatri Migjeni ku gjatë provave si dhe gjatë shfaqjeve trupa e teatrit dhe publiku frekuentojnë ambientet e teatrit jashtë kushteve minimale të komfortit. Problematike paraqitet si situata për ngrohjen në dimër po ashtu për ftohjen në vere duke u bërë pengesë për aktivitete të ndryshme me pasojë rënien e pjesëmarrjes së publikut në teatër.

Kosto e projektit do te jetë:

Kosto e zbatimit	19,684,889
Kosto e projektimit	0
Kosto mbikëqyrje	283,140
Kosto kolaudim	31,971
Kosto Totale e Projektit	20,000,000

Qëllimi është :

- Ngrohje ekonomike, komfort me i lartë, duke ndërhyrë në një rrjet të vjetër dhe të amortizuar.
- Krijimi i komfortit më të lartë për publikun dhe trupën e teatrit duke mbështetur dhe zhvillimin e jetës artistike në qytet me instalimin e një sistemi të ri ngrohje dhe ftohje.

Bashkëlidhur fisha-projekti P08220.Q1.O3.A27 Instalimi i sistemit te ngrohjes dhe ftohjes Teatri me vlerë 20,000,000 lekë.

8. Në Programin P08130.Q1.O1.A15.Shpenzime per mirembajtjen e funksionimin e terreneve sportive

Në buxhetin e vitit 2024 të miratuar më VKB nr 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër” është planifikuar ruajtja e godinës së Stadiumit “Loro Boriçi” me fond 2,897,336 lekë.

Pasi është saktësuar preventivi i ketij shërbimi del që nevojiten 5,834,260 lekë për kryerjen e tij me një vëndroje me tre turne. Pra nevojitet një shtesë buxheti prej 2,936,924 lekë

Për shërbimin e ruajtje së godinës të Stadiumit Loro Boriçi me datën 05.10.2021 është lidhur kontrata nr.1 me nr .prot 10387/16 me objekt “Ruajtja e godinës për administrim dhe mirëmbajtje e Stadiumit “Loro Boriçi” deri me 31.12.2021.

Me datën 31.12.2021 është lidhur kontrata nr.2 me nr .prot 24860 me objekt “Ruajtja e godinës për administrim dhe mirëmbajtje e Stadiumit “Loro Boriçi” deri me 31.12.2022.

Me datën 28.12.2022 është lidhur kontrata me nr.3 me nr. prot 19348 me objekt “Ruajtja e godinës për administrim dhe mirëmbajtje e Stadiumit “Loro Boriçi” deri me 01.01.2023.

Me datën 29.12.2023 është lidhur kontrata me nr.4 me nr . prot 20652 me objekt “Ruajtja e godinës për administrim dhe mirëmbajtje e Stadiumit “Loro Boriçi” deri me 11.03.2024.

Marreveshja kuadër nr .10387/15 date 01.10.2021 është lidhur me pagën minimale 30,000 lekë.

Ndërkohë referuar VKM Nr 158 datë 12.03.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” paga minimale bëhet nga 30,000 lekë ne 32,000 lekë.

Referuar VKM Nr 604 datë 14.09.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” paga minimale bëhet nga 32,000 lekë ne 34,000 lekë.

Referuar VKM Nr 113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, paga minimale bëhet nga 34,000 lekë në 40,000 lekë duke filluar nda data 01.04.2023.

Në nenin 24 të kontratës përcaktohet se : “Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose mbas datës së nënshkrimit të kontratës ndonjë ligj,rregullore,urdhëresë,urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ,nxirret ose ndryshon dhe ndikon në kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës”.

Si rrjedhojë e fakteve më sipër operatori me shkresën nr 7 datë 05.04.2024 drejtuar DPMOP kërkon amendimin e kontratës me vlerën 1,417,392 lekë duke filluar nga data 01.04.2022 deri më 31.08.2023 për një periudhë 5 mujore me pagën minimale 32,000 lekë , nga data 01.09.2022 deri më 31.03.2023 për një periudhë 7 mujore me pagën minimale 34,000 lekë,nga data 01.04.2023 deri më 11.03.2024 për një periudhë 11.5 muaj me page minimale 40,000 lekë. Bashkëngjitur shkresës së operatorit është dhe preventivi që është kontrolluar nga institucioni perkates.

Prandaj kërkojmë që nga rishpërndarja e fondeve të papërdorura t’i shtohet Buxhetit të vitit 2024 në zërin e shpenzimeve 602 në aktivitetin P08130.Q1O1.A15 “Ruajtja e godines per administrim dhe mirembajtje e Stadiumit “Loro Boriçi ” vlera 1,417,392 lekë.

Bashkëlidhur fisha-projekti P08130.Q1.O1.A15.Shpenzime per mirembajtjen e funksionimin e terreneve sportive. (shtese) me vlerë 4,354,316 lekë.

IV. Planifikim, menaxhim dhe administrim

Në buxhetin e vitit 2024 janë parashikuar shpenzime për objektin: “Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës” me vlerë 537,000 lekë. Në zbatim të VKB nr.54, datë 29.12.2023 ”Për një ndryshim në VKB nr.71 datë 27.12.2023 dhe për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr.12,datë 20.07.2023” për mbylljen e institucioneve të varësisë të Bashkisë Shkodër si dhe duke patur parasysh strukturën e re të Bashkisë nr.30 datë 24.01.2024 i ndryshuar, mobilimin e ambjenteve të rikonstruara te Protokoll-Arkivës, transferimin e zyrave në ambjentet që do të rikonstruktohen te godina e ish Konviktit Safet Spahiu (ish.ADISA), amortizimit të paisjeve ekzistuese si edhe nevojave të vazhdueshme të administratës për rinovimin e paisjeve të ndryshme të zyrave si rafte, tavolina pune,

karrige dhe kondicionerë për zyra dhe salla mbledhjesh, rezulton që buxheti i parashikuar për vitin 2024 është i pamjaftueshëm.

Për këtë qëllim kërkohet shtesë fondi në vlerën 10,000,000 lekë.

Bashkëlidhur fisha-projekti P01110.Q3.O1.A4.Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës (Shtesë) me vlerë 10,000,000 lekë .

V. Aktivitet kulturore

Drejtoria e Kulturës përgjatë vitit 2024 do të organizojë aktivitete kulturore artistike të zhanreve të ndryshme. Fokusi i saj është të shndërrojë Shkodrën në një skenë të madhe me artistë kombëtar dhe ndërkombëtar, promovues të trashëgimisë tonë kulturore por edhe ndërthurje dhe shkëmbim eksperiencash me qytete europiane, nepërmjet aktiviteteve sa më të shtrira në kohë, në hapësirë dhe gjithashtu duke shtuar standartin dhe cilësinë .

Në buxhetin e vitit 2024, të miratuar me VKB Nr. 55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të bashkisë Shkodër", i ndryshuar është planifikuar projekti P08220.Q1.O3.A15 "Realizimi i aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Kulturës" dhe P08220.Q1.O3.A24 Shërbime fonie, skene dhe ndriçimi për aktivitetet e kulturës , të cilat mbulojnë disa nga aktivitetet traditë të drejtorisë së kulturës si dhe aktivitetet që këtë vit janë inovatore, të cilat disa do të realizohen nga Bashkia Shkodër dhe disa do të vlerësohen nga Këshilli Artistik i Bashkisë Shkodër dhe disa do të realizohen nga Bashkia Shkodër, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.40 datë 26.10.2023 "Për një ndryshim në VKB nr.27 datë 01.06.2016 "Për ngritjen e Këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër".

Drejtoria e Kulturës mendon të zgjerojë dhe të shtojë fondin e aktiviteteve sipas fisha-projektit:

1. **P08220.Q1.O3.A15 "Realizimi i aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Kulturës"**

- **"Koncertet e Verës "** Koncertet e verës do të jenë të shtrirë në hark kohor dhe gjeografik. Për vitin 2024 janë parashikuar koncerte cdo fundjavë gjatë të gjithë verës duke filluar nga qershori deri në fund të gushtit në Shkodër dhe në Velipojë. Do të jenë të ftuar artistë nga e gjithë Shqipëria, këngëtarët më të mirë të tregut dhe sigurisht këngëtarët dhe artistët Shkodranë. Ky projekt i jep rëndësi gjithashtu përfshirjes së të rinjve si pjesë e grupeve muzikore ose solistë. Gjithashtu do të zhvillohet aktiviteti për "Dita Nderkombëtare e Muzikës" me datë 21 Qershor. Do të mbështeten aktivitete si "Verë dhe Portokalle" dhe "Maratona e Këngës Popullore". Prandaj është menduar të mbështesim me fond shtesë 3,500,000 lekë.
- **"Shkodra N'fest"** është projekt i cili do të shtrihet gjatë të gjithë dhjetorit. Ky projekt ka për qëllim të shtojë atmosferën e festave në qytet duke organizuar çdo ditë koncerte dhe festa që përfshijnë artistë profesionistë të fushave të ndryshme, grupe rinore, të ftuar special dhe një hapësirë e veçantë do ti dedikohet tërësisht aktiviteteve për fëmijë. Në sheshin para Bashkisë Shkodër do të vendosen disa shtëpiza të vogla druri të cilat ofrojnë shërbime dhe aktivitete të ndryshme festive. Gjithashtu një rëndësi e veçantë do ti jepet dekorimit të qytetit i shtrirë në të gjitha rrugët e Shkodrës dhe duke u finalizuar në sheshin përpara Bashkisë, vend i cili do të kthehet në qendrën e festimeve. Prandaj është menduar të mbështesim me fond shtesë 2,000,000 lekë.

Bashkëlidhur fisha-projekti P08220.Q1.O3.A15.Realizimi i Aktiviteteve te organizuara nga Drejtoria e Kultures. (shtesë) me vlerë 5,500,000 lekë.

2. P08220.Q1.O3.A24 Shërbime fonie,skene dhe ndriçimi për aktivitetet e kulturës

Në Bashkinë Shkodër zhvillohen një seri eventesh dhe festivalesh të një rëndësie domethënëse dhe me qëllimin për të kthyer Shkodrën në destinacion dhe qendër eventesh. Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinsë dhe Sportit beson tek vlerat e trashëguara dhe është impenjuar të punojë në këtë drejtim për të çuar më tej vlerat tona. Nisur nga kjo, Bashkia Shkodër kërkon që këto aktivitete të realizohen në nivelet më të larta profesionale, duke i dhënë rëndësinë e duhur të gjithë komponentëve artistikë dhe teknik. Me këtë shifër Bashkia Shkodër mbështet të gjithë aktivitetet vjetore që kërkojnë shërbim fonie ndricimi dhe skene që nuk e kanë të përfshirë tek fishat përkatëse ,gjithashtu investim ne blerjen e paisjeve audio dhe ndricimi . Për këtë është planifikuar fond shtesë sherbimi dhe investimi për foni dhe ndriçim në vlerën 2,500,000 leke.

Bashkëlidhur fisha-projekti P08220.Q1.O3.A24. Shërbime fonie, skene dhe ndriçimi për aktivitetet e kulturës (shtesë) me vlerën 2,500,000 lekë.

3. P08220.Q1.O3.A26 Blerje paisje fonie, ndriçimi dhe materiale skenike për Teatrin “Migjeni”

Teatri “Migjeni” ka një traditë 75 vjeçare mbi supe dhe kjo sigurisht që e rrit shumë përgjegjësinë dhe vëmendjen ndaj tij. Nevojat e Teatrit janë të shumta dhe më emergjentet është dalë në konkluzion që janë të nevojshme, pas konsultimit dhe me ekspertët, shtimi i pajisjeve të ndriçimit si prozhektore, mixer, ndriçim led dhe pajisjeve audio si mikrofona wirless, mikrofona akullore, mixer audio etj. Gjithashtu blerja e materialeve skenike të domosdoshme për realizimin e shfaqjeve teatrore si dërrasë, hekur, beze, tekstil, shirita led, dhe çdo detaj i nevojshëm për skenë. Teatri “Migjeni” ka në planifikim shfaqje te mëdha teatrore, masive dhe për të arritur edhe teknikisht nivelin e duhur artistik është planifikuar fond shtesë investimi për audio, ndriçim dhe materiale skenike në vlerën 6.000.000 lekë.

Sa më sipër kërkojmë miratimin tuaj, për të vijuar me rishpërndarjen e fondeve në programin 08220 “Trashëgimia kulturore, aktivitetet artistike dhe kulturore” sipas fishës bashkëlidhur.

Bashkëlidhur fisha-projekti P08220.Q1.O3.A26. Blerje paisje fonie, ndriçimi dhe materiale skenike për Teatrin “Migjeni” me vlerë 6,000,000 lekë.

VI. Shërbime sociale

1. Projekti: “HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë” është shpallur fitues në kuadër thirrjes për projekte “Erasmus+”, një program i Bashkimit Evropian, i financuar nga Agjencia Kombëtare Franceze e rinisë dhe sportit është miratuar me anë të vendimit të këshillit bashkiak Nr.8, dt.31.01.2024 “Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë shkodër për “Projektin Hold On - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë”.

Qëllimi i projektit është përmirësimi i aksesit e të rinjve në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor dhe angazhim proaktiv i tyre në përmirësimin e rezultateve të shëndetit mendor.

Buxheti i Projektit:

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Buxheti i Projektit për Bashkinë Shkodër do të jetë 3,304,000 lekë në total për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit, ku përfshihet pjesa e financuar nga Programi dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për projektin:

- Buxheti i financuar nga Programi për Bashkinë Shkodër do të jetë 27,562 euro, i konvertuar në 2,869,000 Lekë (86.83%) për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.
- Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për Projektin do të jetë 435,000 Lekë (13.17%), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Ky kontribut do të merret nga tepricat e programit 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” të vitit 2023.

Ky kontribut do të merret nga tepricat e programit 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” të vitit 2023. Konkretisht:

- P10430.Q4.O2. A4. “Asnjë Fëmijë Jashtë”;
- P10430.Q4.O2.A7. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje, procedura të paprocuruara për vitin 2023.

Vlerësojmë të rëndësishme të nënvizojmë që Bashkia Shkodër do të aplikojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rimbursimin e vlerës së TVSH-së.

Bashkëlidhur fisha-projekti Projekti: P10430. Q4.02.A14 “Projekti HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë” - 2022-2-FR02-KA220-YOU-000096911 (shtesë) me vlerën 435,000 lekë.

2.Sektori I Rinise

Sektori I Rinise përgjatë vitit 2024 do të organizojë aktivitete rinore artistike. Rinia e Bashkisë Shkodër është një forcë aktive në komunitet, e cila përfshin individë të apasionuar dhe të përkushtuar për të kontribuar në zhvillimin e qytetit dhe të kulturës së tij. Ndërkaq, nevoja për të përfshirë rininë është e rëndësishme për të siguruar një përqendrim më të mirë të potencialeve të tyre në dobi të zhvillimit të qytetit dhe të komunitetit të tij në përgjithësi.

Sektori i Rinisë mendon të zgjerojë dhe të shtojë fondin e aktiviteteve sipas fishe-projektit:

“Realizimi i aktiviteteve të organizuara nga Sektori i rinise”

Dita Ndërkombëtare e Rinisë: Kjo është një mundësi e shkëlqyer për të festuar dhe të nderuar rininë në një atmosferë argëtuese dhe frymëzuese. Aktivitetet argetuese, si lojërat sportive, konkurse artistike, dhe punëtori kreative, do të inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të rinisë. Ndërsa një koncert i organizuar me artistë të rinj do të jetë një platformë e shkëlqyeshme për të shfaqur talentet muzikore dhe artistike të tyre.

Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit: Një ditë e dedikuar vullnetarizmit do të inkurajojë rininë të angazhohen në aktivitete të dobishme për komunitetin e tyre. Përfshirja në fushata të pastrimit të mjedisit, ndihmën për të moshuarit, ose organizimin e aktiviteteve bamirëse do të ndihmojë në kultivimin e ndjenjës së përgjegjësisë sociale dhe solidaritetit në mesin e rinisë.

Organizimi i Javës së Demokracisë Rinore: është një mundësi e shkëlqyer për të trajnuar, shkëmbyer ide dhe përvoja, si dhe për të përparuar politikatat rinore dhe për të promovuar angazhimin e rinisë.

Eskursione Rinore: Eskursionet rinore janë një mënyrë e shkëlqyer për të rinjtë për të eksploruar natyrën, për të ndërtuar lidhje të reja, dhe për të pasur përvoja të reja. Organizimi i udhëtimeve në zonat e bukura natyrore ose në qytete të tjera të vendit do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive aventuristike dhe në ndërgjegjësimin ambiental të rinisë.

Përveç aktiviteteve të përmendura më lart, mund të shtohen edhe disa workshope dhe aktivitete të tjera që mund të ofrojnë një gamë më të gjerë të mundësive për të rinjtë në Bashkinë Shkodër. Këto aktivitete ofrojnë një mundësi të shkëlqyer për të rinjtë për të marrë pjesë në jetën shoqërore, për të zhvilluar aftësitë e tyre dhe për të kontribuar në komunitetin e tyre. Bashkia Shkodër mund të shfrytëzojë këto iniciativa për të inkurajuar përfshirjen dhe angazhimin e rinisë në ndërtimin e një shoqërie më të fortë dhe më të përfshirë.

Me disponimin e këtij buxheti të veçantë për rininë, të rinjtë e Bashkisë Shkodër do të kenë mundësinë e krijimit dhe realizimit të aktiviteteve të tyre të preferuara dhe të nevojshme për zhvillimin e tyre personal dhe kontributin në komunitet. Prandaj është menduar të mbështesim me fond total së 2,087,000 lekë të shpërndara sipas fishave.

Bashkëlidhur fisha-projekti :

P10430.Q4.O1.A4 -Shpenzime për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plotë të Qendrës Rinore Atelie me vlerën 1,025,000 lekë.

P10430.Q4.O1.A5 - Shpenzime për sigurimin e funksionimit të plotë të Qendrës Rinore me vlerën 62,000 lekë.

P10430.Q4.O2. A14- "Realizimi i Aktiviteteve për Rininë" me vlerën 1,000,000 lekë.

VII. Aplikim për të paraqitur kandidaturën për të qënë "Qyteti Evropian i Sportit 2025".

Bashkia e Shkodrës ka paraqitur kandidaturën për të qënë "Qyteti Evropian i Sportit 2025". Ky titull përfaqëson një çmim që i ndahet qyteteve të Evropiane nga ACCESS Evrope (Federata Evropiane e Kryeqyteteve dhe Qyteteve të Sportit), duke u bazuar në parimet e përgjegjësisë dhe etikës. Kjo njohje i jepet qyteteve të cilat e kuptojnë dhe e promovojnë rolin e sportit si një faktor bashkues në shoqëri, për të përmirësuar cilësinë e jetës, mirëqenien psiko-fizike dhe për të ndihmuar në integrimin e plotë të klasave sociale brenda komunitetit.

Federata Evropiane e Kryeqyteteve dhe Qyteteve të Sportit (ACES) është një organizatë jo-fitimprurëse me qendër në Bruksel, e cila punon që prej vitit 1999 për të nxitur sportin tek të gjithë qytetarët e Bashkimit Evropian. Qëllimi kryesor i ACES është të promovojë sportin dhe aktivitetet sportive për të gjitha grupet e popullsisë, duke përfshirë grupe të pafavorizuara, fëmijë, pleq, dhe ata me aftësi të kufizuara. Përveç aspektit profesional të sportit, ACES synon të krijojë një platformë për bashkërendimin social, duke e konsideruar sportin si një mjet për të përmirësuar shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. "Qyteti Evropian i Sportit" është një iniciativë që ka marrë njohje nga Komisioni Evropian. Përveç kësaj, ACES Evrope është një partner zyrtar i Komitetit Evropian në Javën Evropiane të Sportit. Po ashtu, ACES Evrope është partner zyrtar i UNESCO-s, Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë. Titulli "Qytet i Sportit" për vitin 2025 do të japë mundësi për:

- **Njohje Ndërkombëtare:** Duke e bërë Shkodrën "Qytet i Sportit" në nivel evropian, ky titull do të rrisë vizibilitetin dhe prestigjin ndërkombëtar të qytetit.
- **Trashëgimi Sportive:** Qytetet fituese ofrojnë një platformë më të mirë për pjesëmarrjen në aktivitete sportive për qytetarët e tyre në të ardhmen, duke e përhapur kulturën sportive.

- **Pjesëmarrje në një rrjet aktiv:** Ky titull hap mundësinë për shkëmbimin e praktikave më të mira me qytete të tjera në Europë për promovimin e sporteve dhe aktiviteteve sportive, si dhe për të përmirësuar politikat vendore në sport.
- **Grante nga BE-ja:** Përfshirja e këtyre qyteteve në projekte dhe thirrje të ndryshme të Bashkimit Evropian, ofron mundësi për të përfituar nga fonde dhe grante për zhvillimin e projekteve sportive në komunitet.

Aplikimi për këtë kandidaturë udhëhiqet nga rregullorja e ACES "Rregullat e Përgjithshme që Udhëheqin Procesin e Përzgjedhjes së Kryeqytetit, Komunitetit, Qytetit dhe Rajonit Evropian të Sporteve", e cila është miratuar me 1 Dhjetor 2022. Bashkia e Shkodrës angazhohet të ndjekë të gjitha hapat e përcaktuara në këtë rregullore dhe të mbulojë pagesat që duhet të bëjë gjatë procesit të aplikimit:

- Pagesa e tarifës së aplikimit: 2,844 Euro (Artikulli 22.1 i Rregullores)
- Pagesa për të drejtën e imazhit: 10,000 Euro (Artikulli 26.4 i Rregullores)
- Kostoja e mikëpritjes për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit ACES Europe: 12,300 Euro (akomodim, qëndrim, transport, dhe shpenzime udhëtimi për përfaqësuesit e Komitetit të Vlerësimit prej 4-6 anëtarësh, gjatë vizitës 3 ditore në Shkodër) (Appendix I)

Në përlogaritjen e vlerës në lek për fishën P08130.Q1.O1.A15 Shkodra Qyteti Evropian i Sportit 2025 është përdorur kursi i këmbimit të bankës së Shqipërisë datë 18.4.2024 (101.35 Lek).

Qyteti kandidat mban kostot/programin e mikëpritjes për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të ACES Europe (akomodim/qëndrim/transport/shpenzime udhëtimi për përfaqësuesit e Komitetit të Vlerësimit prej 4-6 anëtarësh, detyrim ndaj ACES Europe) - arritja e Komisionit të ACES Europe në Shkodër mund të ndodhë në Gusht 2024, vendimi përfundimtar i Komitetit të Vlerësimit të ACES Europe rreth 15-20 ditë pas vizitës në Shkodër.

Për këtë arsye lind e nevojshme parashikimi i një fondi për mbulimin e shpenzimeve në zërat e buxhetit vjetor.

Bashkëlidhur fisha-projekti P8130.Q1.O1.A15. Shkodra Qyteti Evropian i Sportit 2025 me vlerën 2,549,000 lekë.

VIII. Mbështetja e Trajtimit të Studenteve sh.a Shkodër

Duke qenë se Trajtimi i Studentëve sha Shkodër është institucion me interes publik dhe në varësi të Bashkisë Shkodër, referuar VKM- së nr. 350, datë 29.04.2020 "Për transferimin e pronësisë të 100% të aksioneve të shoqërisë Trajtimi i Studentëve sha Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Shkodër", që zvillon aktivitetin e saj në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, referuar bazës ligjore:

- VKM- së nr. 350, datë 29.04.2020 "Për transferimin e pronësisë të 100% të aksioneve të shoqërisë Trajtimi i Studentëve sha Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Shkodër"
- Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar,
- Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar,
- Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar,
- fishes nr.23, P09230.Q2.O1.A11 të Buxhetit të Bashkisë Shkodër « Mbështetja e Ndërmarrjes së Trajtimit të Studentëve » për vitin 2023 e në vijim,

- VKB-së nr.55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër),

Shoqëria kërkon miratimin dhe lidhjen e një marrëveshje bashkëpunimi midis dy institucioneve, e cila do të shërbejë për rregullimin e marrëdhënieve institucionale financiare midis Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë ‘Trajtimi të Studentëve’ sha, për zbatimin e programit të bashkëpunimit, me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore për individët e akomoduar.

1. Aktiviteti i Shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është akomodimi i studentëve në ambjentet e konviktit ,tashmë duke ofruar edhe shërbime të tjera sipas kërkesës për individë të interesuar për akomodim.

Shoqëria Trajtimi i Studentëve sha Shkodër, ofron shërbim hotelerie ditor, mujor dhe vjetor, për studentët që frekuentojnë fakultetet e ndryshme në qytetin e Shkodrës, dhe individë të tjerë që shprehin kërkesën për akomodim. Shoqëria administron 3 godina aktualisht, me kapacitet rreth 470 persona.

Konkretisht, Shoqëria ka zgjeruar gamen e shërbimeve e objektin e veprimtarisë së saj dhe parashikon për vitin 2024 e në vijimësi, furnizimin dhe trajtimin e studenteve me ushqim, fjetje dhe shërbime të tjera hotelerie, furnizimin dhe trajtimin e personave të ftuar apo vizitorë, persona të tretë jo studentë, delegacione apo personalitete të huaja apo shqiptar, me fjetje dhe shërbime të tjera hotelerie, sipas kërkesës, sipas nevojës së Bashkisë Shkodër, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke kryer çdo operacion tregtar dhe financiar të nevojshëm, që lidhet drejtpërdrejt ose terthorazi me objektin e Shoqërisë, e shërbime të tjera si ambjente me qira, shërbim parking, lavaxteri etj, duke diversifikuar burimet e të ardhurave.

Drejtimi vlerëson se pozita e favorshme gjeografike, shërbimet e ofruara, çmimet konkurruese dhe kërkesat e ndryshme në rritje për akomodim, e favorizojnë Shoqërinë duke rritur fluksin e akomodimit për këtë vit. Aktualisht, duke patur parasysh kushtet aktuale, ndryshimet e bëra dhe vënia në zbatim që në muajin Nëntor 2023, ka sjellë impakt në rritjen e të ardhurave të Shoqërisë, referuar të njëjtës periudhë në krahasim me të paktën 3 vitet e kaluara.

Periudha	Të ardhura (mijë lekë)
Nëntor 2021-Shkurt 2022	588
Nëntor 2022-Shkurt 2023	1430
Nëntor 2023-Shkurt 2024	1781

Thënë këtë të fundit, është e nevojshme mbështetja financiare e Bashkisë Shkodër për rehabilitimin e ambjenteve të dy prej tre godinave ekzistuese në administrim të Shoqërisë, për mirëmbajtje, kosto e punës dhe pjesërisht furnitura si energji elektrike, ujë, EKR, etj, në funksion të objektit të saj të veprimtarisë, duke bërë të mundur shfrytëzimin e të gjitha kapaciteteve tona, sepse kryesisht shfrytëzohet më tepër Godina nr. 2 e rikonstruktuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me kushte bashkëkohore.

Duke patur parasysh ndryshimet ekonomike, indekset e çmimeve në rritje të materialeve të konsumit e lëndë e parë, të shërbimeve nga të tretë për mirëmbajtje, amortizim, furnitura, paga, etj, mbështetja financiare për vitin 2024 është parashikuar të jetë në shumën 16,000,000 lekë; kjo e fundit si diferencë duke llogaritur edhe mbështetjen financiare nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në formën e transfertave mujore për Shoqërinë Trajtimi i Studentëve sha Shkodër, për shpenzime operative, i klasifikuar si insitucion i arsimit të lartë.

Në përfundim, drejtimi, duke mbajtur konstant indekset e çmimeve të furniturave, pagat minimale në shkallë vendi, koeficientët e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vlerëson se fondi i kërkuar për alokim nga Bashkia Shkodër, do të përdoret për koston e punës, pjesërisht furnitura ose/dhe për detyrime të tjera, që mund të krijohen sipas situatës ekonomike të Shoqërisë:

Zërat e shpenzimeve/2024	Parashikimi 2024 (mijë lekë)
Paga personeli	11,500
Kontribute shoqërore, shëndetësore dhe TAP	1,920
Trajtime/Paga Këshilli Mbikqyres	1,144
Furnitura (energji elektrike dhe ujë)	1,436
Totali	16,000

2.Raportimi

Fondi i kërkuar, do të lëvrohet në formën e transfertave mujore, sipas nevojave të Shoqërisë dhe do të raportohet për çdo shpenzim, duke relatuar dhe bashkëngjitur dokumentet justifikuese. Shoqëria përgjigjet për çdo kërkesë specifike të informacionit për pjesëne buxhetit, që financohet nga Bashkia Shkodër dhe që mund të kërkohet gjatë vitit.

Bashkëlidhur fisha-projekti P09230.Q1.O1.A26 Mbështetje e Trajtimit të Studentëve sha. Shkoder me vlerën 16,000,000 lekë.

IX. Për trajtimin e qenëve të rrugës

Bashkia Shkodër konform përmbushjes së detyrimeve , sipas përcaktimeve ligjore të parashikura në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, gjithashtu sipas parashikimeve të Buxhetit të vitit 2023 sipas VKB nr.55,datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, Vendimit nr. 75 date 23.02.2024 “ Për miratimin e rishpërndarjes së fondit, brenda të njëjtit program për vitin 2024”.

-Në aktivitetin P04220.Q1.O1.A1 “Trajtimi i qenve të rrugës” fond i parashikuar për vitin 2024 me kod 602 “Shpenzime operative” , është menduar që trajtimi i qenve të rrugës të realizohet nga vetë stafi i Bashkisë. Për realizimin e këtij aktiviteti është e nevojshme paisja e klinikës me një automjet te pershtatshem per transportimin e qenve apo materialeve të tjera qe lidhen me administrimin e strehëzes në zërin investime me kod 231 duke shtuar nën aktivitetin P04220.Q1.O1.A1/A5 Blerje automjet për transport qen, sipas fishës bashkelidhur me vlerën 1,000,000 lekë.

Detajimi i tabelës - Shtesa e Buxhetit të vitit 2024 në lekë është si më poshtë:

Shtesa viti 2024

TABELA 4

Në lekë

Institucion i	Emërtimi i Aktivitetit	Shpenzime operative	Transferime	Shpenzimet Kapitale Të Patrupëzuara	Shpenzimet Kapitale Të Trupëzuara	Totali 2024
Bashkia Shkodër	P04520.Q1.O3.A5.Sistemim Asfaltim rruga e varrezave të qytetit "Fshati Golem", Bashkia Shkodër			-	11,248,000	11,248,000
	P04520.Q1.O3.A6. Sistemim Asfaltim rruga 'Pjetrushi' pranë varrezave, Grudë e Re, Bashkia Shkodër			999,000	26,769,000	27,768,000
	P04520.Q1.O2.A10..Rikonstruksion rruga e 'Foljetave', Bashkia Shkodër			-	8,400,000	8,400,000
	P06140 .Q1.O1.A6 Tarifa/taksa për aplikime apo shërbime në lidhje me projekte të bashkisë Shkodër	5,000,000				5,000,000
	P09230.Q1.O1.A26 Mbeshtetje e Trajtitimit të Studentëve sha. Shkoder			16,000,000		16,000,000
DPMOP	P01110.Q3.O1.A15 Rikonstruksion godina ish konvikti Safet Spahia				32,408,841	32,408,841
	P08220.Q1.O3.A27 Instalimi i sistemit te ngrohjes dhe ftohjes Teatri Migjeni				20,000,000	20,000,000
Bashkia Shkodër	P04220.Q1.O1.A1. Trajtimi i qenve të rrugës. (shtese)				1,000,000	1,000,000
	Projekti: P10430. Q4.O2.A14 "Projekti HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë" - 2022-2-FR02-KA220-YOU-000096911 (shtese)	435,000				435,000
NSHPP	P04240.Q1.O1.A3 - Menaxhimi dhe funksionimi i sektorit te kullimit dhe ujitjes (shtese)	405,000				405,000
	P04240.Q1.O1.A4 - Pastrim kanalesh kulluese në Nj.A. (shtese)				18,000,000	18,000,000
	P04520.Q1.O1.A3 Mirëmbajtje rrugë dhe trotuanre në territorin e Bashkisë së Shkodrës (shtese)	35,000,000				35,000,000
	P06260.Q3.O1.A7 Rikonstruksion ambiente magazine dhe te jashte				9,200,000	9,200,000
	P06260.Q2.O1.A2. Shërbimi i mirëmbajtjes së siperfaqeve ujore (shtese)	10,000,000				10,000,000
	P06260.Q3.O1.A8 Tualete publike, pika turistike.	1,000,000				1,000,000

Bashkia Shkodër	P04130.Q3.O2.A2. Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në plazhe dhe në destinacione të tjera turistike	550,000			950,000	1,500,000
DPMOP	P08130.Q1.O2.A7 Furnizim vendosje dhe blerje materiale Pallati i Sportit	7,500,000				7,500,000
	P09120.Q1.O1.A30 Blerje materiale për mirëmbajtje tualete ,terrace, rrjete elektrike shkolla dhe kopshte	14,854,973				14,854,973
	P09320.Q1.O2.A7 Blerje materiale për mirëmbajtjen e tualeteve të shkollave të mesme	6,500,000				6,500,000
	P09120.Q1.O3.A8 Instalimi i ngrohjes qendrore në shkollat 9 vjeçare			824,130	29,175,870	30,000,000
	P08130.Q1.O1.A15. Shpenzime për mirëmbajtjen e funksionimin e terreneve sportive. (shtese)	4,354,316				4,354,316
	P08130.Q1.O2.A6 Fusha të pambuluara sportive shkolla Xheladin Fishta				5,145,027	5,145,027
	P10430.Q4.O1.A4 Shpenzime për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plote të Qendrës Rinore Atelie	1,025,000				1,025,000
Bashkia Shkodër	P08220.Q1.O3.A26. Blerje pajisje fonie ndricimi dhe materiale skenike për Teatrin "Migjeni"	2,000,000			4,000,000	6,000,000
Bashkia Shkodër	P10430.Q4.O1.A5 Shpenzime për sigurimin e funksionimit të plote të Qendrës Rinore	62,000				62,000
	P10430.Q4.O2. A16 "Realizimi i Aktiviteteve për Rininë"	1,000,000				1,000,000
	P08220.Q1.O3.A15. Realizimi i Aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Kultures. (shtese)	5,500,000				5,500,000
	P08220.Q1.O3.A24. Shërbime fonie, skene dhe ndricimi për aktivitetet e kultures (shtese)	2,500,000				2,500,000
	P01110.Q3.O1.A4. Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës (Shtesë)				10,000,000	10,000,000
	P8130.Q1.O1.A15. Shkodra Qyteti Evropian i sportit 2025	1,247,000	1,302,000			2,549,000
	TOTALI	98,933,289	17,302,000	1,823,130	176,296,738	294,355,157

KRYETAR

Benet BECI



Zv. Kryetar

Zv. Kryetar
[Handwritten signature]

Zv. Kryetar
[Handwritten signature]

Drejtorja e Tatim Taksave

[Handwritten signature]

Drejtorja e Financës

[Handwritten signature]

Drejtorja e Administrimit të Sistemeve
Menaxhimit të ZIN, Projekteve dhe
Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit

[Handwritten signature]

Drejtorja e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor

[Handwritten signature]

Ndermarrja e Shërbimeve të punëve publike

[Handwritten signature]

Drejtorja e Kultures, Rinise ,Sportit,
arsimit , Rinise dhe Teatri Migjeni

[Handwritten signature]

Drejtorja e Ndihmes Ekonomike

[Handwritten signature]

Drejtorja e Shërbimeve Sociale

[Handwritten signature]

Drejtorja e Burimeve Njerëzore

[Handwritten signature]

Drejtorja e Mjedisit dhe energji se
rinovueshme

[Handwritten signature]

p/ Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
trajtimit të AMTP

[Handwritten signature]

p/ Drejtorja e planifikimit dhe zhvillimit
te territorit

[Handwritten signature]

Drejtorja e Kontrollit dhe Zhvillimit të
Territorit

[Handwritten signature]

Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit

[Handwritten signature]

Policia Bashkiake

[Handwritten signature]

Drejtorja e Turizmit

[Handwritten signature]

Drejtoria e shërbimeve të brendshme

Hasan Kema

Njësia e Emergjencave civile

Keleci

Drejtoria e përgjith. e mirëmb. së objekteve publike

Stozef Tulla